



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE INVESTIMEVE TË HUAJA

Nr. 1313/2023

Vlorë, më: 30. 10 2023

PROCESVERBAL KONSULTIM PUBLIK

NJËSIA ADMINISTRATIVE NOVOSELE

Datë: 06.10.2023 Ora: 17:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit afatmesëm 2024-2026 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2024 për Bashkinë Vlorë

Baza Ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” , ligjit nr.146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë; si dhe Urdhrit nr.11769 datë 4.10.2023.

Marrin pjesë:

Kryetari i Bashkisë Vlorë-z. Ermal Dredha, Kryetarja e Këshillit Bashkiak- znj.Elpiniqi Mërkuri, Kryetari i Njesisë Administrative Novosele –Kanan Shakaj, Sekretar i Këshillit Bashkiak-z.Daut Zeraj, këshilltarë të bashkisë, Drejtori i buxhetit dhe financës-Hiqmet Haxhaj, sektori i tatim taksave. drejtorë të Administratës së Bashkisë Vlorë, kryetarë të fshatrave të Njesisë Administrative Novoselë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, Media dhe OJF lokale,

(Në takim marrën pjesë më shume se 30 pjesëmarrës, listëprezenca bashkangjitur)

Takimin e hapi Kryetari i Bashkisë Vlorë, z.Ermal Dredha: Përshendetje, ju falenderoj për pjesëmarrjen. Po celim takimet me njësitë administrative për të diskutuar mbi planifikimin e buxhetit afatmesëm 2024-2026 dhe projektbuxhetin e vitit 2024 për Bashkinë Vlorë. Ky është takimi i dytë që vijon me njësitë administrative në prezencë edhe të anëtarëve të këshillit bashkiak, dhe do të vazhdojme me takimet e tjera, të jemi drejtëpërdrejt me komunitetin në kontakt që të kuptojmë çfarë janë problematikat apo çfarë mund ti shërbejmë komunitetit, për të mbledhur cdo koment, sygjërim dhe diskutim tuajin përpara se të miratojmë projekt buxhetin e parashikuar.



Konsultimi i Buxhetit afatmesëm 2024-2026 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2024 për Njësinë Administrative Novoselë

Konsultoni për më shumë linkun në media lokale

<https://fb.watch/nBn0iUëqse/?mibextid=Iprqdp>

Hiqmet Haxhaj Drejtor i Financës në Bashkinë Vlorë – Prezanton ligjshmërinë e takimit për të diskutuar mbi projektbuxhetin e bashkisë Vlorë për vitin 2024 si dhe për planifikimin e buxhetit afatmesëm 2024-2026. Është hartuar projektbuxheti sipas programve të miratuara nga këshilli bashkiak dhe do të diskutohet me grupet e interesit në secilën njësi të bashkisë Vlorë. Të ardhurat dhe shpenzimet janë parashikuar sipas prioritetit të Planit të Përgjithshëm Vendor 2021-2031 të Bashkisë Vlorë në fushën e turizmit, zhvillimit ekonomik, punësimit, transportit, sipërmarrjes sociale, cilësisë së jetës dhe kohezionit social.

Transfertat e pakushtëzuara në formë granti nga qeveria janë:

Viti 2023 rreth 674 milion lek

Viti 2024 ka një rritje 6% - rreth 710 milion lek

Viti 2025 rreth 748 milion lek

Viti 2026 rreth 788 milion lek

Transfertat specifike:

Viti 2023- 447 milion lek

Viti 2024 – 447 milion lek

Viti 2025- 474 milion lek

Shpenzimet e parashikuara për vitin 2024 për 4 njësitë administrative janë rreth 608 milion lek sipas sektorëve prioritar; zjarrfikës-73 milion lek, ujitje dhe kullim 47.

Për njësinë Novoselë janë një seri investimesh. Sistemi i ujësjellësit, sistemi rrugor, kanalet vaditëse janë të parashikuara në programin buxhetor.

Për Novoselën prioritet është mirembajtja e sistemit ujites dhe kullues në fshatin Bishan në vlerën 95 milion lek, gjithashtu sistem asfaltimit i rruges Hidrovor-Akerni në vlerën 98 milion leke. Këto janë investimet me prioritet.

Për shpenzimet operative të mirembajtjes së rrjetit të kanaleve ujitëse e vaditëse të gjithë territorit janë në process dhe të planifikuara në çdo vit buxhetor. Mbulohet shërbimi i pastrimit, ujitjes dhe kullimit, nëpërmjet ndërmarrjes së shërbimeve publike dhe bordit të kullimit. Shpenzimet e parashikuara për gjithë sektorin e mirembajtjes janë 46 milion 546 mij ne vit. Totali i parashikuar për investimeve për buxhetin afatmesëm është 2 miliard 700 milion.

Banor: Investimet për ujin e pijshëm në zonën tonë ja vlen si projekt dhe do bëhet, por situata për kanalet dhe kullimet janë në një gjendje problematike në Novoselë.


Banore në Novoselë: Duam të rregullohen shkollat dhe kopshtet pasi kanë nevojë për riparime në tualete, furnizimi me ujë, s'kanë depozitë.


Anjeza Shiko-Drejtor-Tatim-Taksa: Njësia ka gjeneruar rreth 50 milion lekë. Duhet të ndërjegjësohemi se është shumë e rëndësishme arkëtimi i taksave të tokës bujqësore pasi ato shërbejnë për investimë në zonë. Dëgjova se kërkohen investime për kanalet ujitëse dhe ndricim por këto dalin nga të ardhurat. Ndarja e buxhetit bëhet në proporcion me të ardhurat që arkëtohen prandaj bashkëpunimi është shumë i rëndësishëm. Numri i bizneseve në njësinë Novoselë është 150. Të bashkëpunojnë të gjithë aktorët që të rritim të ardhurat për njësinë dhe të kemi më shumë investime nga bashkia së bashku me subvencionet që ka detyrim.

Banor: Ne nuk jemi pronar, s'kemi certifikata pronësie, si do paguajmë taksën e tokës bujqësore? Zgjidheni këtë problem që edhe ne të paguajmë sipas detyrimeve që kemi.

Kryetar i fshatit: Ju falenderoj për investimet në 4 vitet në rrugë, ndricime dhe ujësjellës. Por rruga kryesore deri në qendër të fshatit duhet rregulluar, është një kanal vaditës dhe aty shkarkojnë ujrë e zeza, duhet dhe një trotuar për të kaluar njerëzit. Duam një punëtor për në varreza se aty janë 5 fshatra dhe është shumë e nevojshme.

Banor i fshatit Bishan: Kanali i vaditjes që fillon nga Mifoli e këtij do bëhet e do na ndihmoj. Kemi një problem në fshat me punën e ndërtimeve. Nuk rregullojmë dot një cati, nuk marr dot një leje sepse s'kemi certifikata pronësie.





Kanan Shakaj-Kryetar i Nj. Adm. Novoselë; Për sa i përket problemit që doli nga kryetari i fshatit Novoselë përsa i përket kullimit kishim një eskavator që mund të ketë punuar 3 muaj, Nuk është bërë punë me kullimin. Për pastrimin falë mbështetjes që ju na keni dhënë po punohet shumë mirë, drejtori i urbanistikës, infrastrukturës dhe bujqësisë u jës jellës të gjithë na kanë mbështetur. Edhe me projektet e urbanistikës jemi të kënaqur.

Për fondin e buxhetit për kullimin dhe vaditjen, jemi e vetmja njësi administrative që kemi probleme me vaditjen. Vaditet nga Kuci në Tërbac dhe nuk vaditet fusha e Myzeqesë. Fieri i ka bërë të gjitha. Ne kemi bërë një projekt ide para 4 vjetësh në 3 variante. Një variant të vinte nga Pocemi dhe është lënë në mes, një variant të vinte nga ana e Fierit, një variant aty.

Ermal Dredha-Kryetar i Bashkisë Vlorë: Sa është kosto?

Kanan Shakaj-Kryetar i Nj. Adm. Novoselë - Po ta marrim nga Fieri 14 milion euro. Këtë nuk e ka bashkia, ne duhet të bëjmë kërkesën. Projekt idenë e kemi gati, të cohet në Tiranë në Ministrinë e Bujqësisë të kërkojmë fonde. E lamë me zëvendës Ministrin e Bujqësisë që do të merrnim fond për Novoselën por deri tani nuk është bërë asgjë. Na është thënë nga bashkia të cohet një projekt ide por ne e kemi gati projektidenë.

Ermal Dredha-Kryetar i Bashkisë Vlorë: E keni cuar ne bashki?

Kanan Shakaj- E kemi cuar në bashki. Një kopje duhet ta ketë drejtor i bordit. Unë e kam një kopje në zyrë. Ta cojmë prapë. Sikur edhe pjesë pjesë të bëhet në 4 vjet. Është e vetmja njësi që ka 6 mijë e ca hektarë tokë.

Banor : Kam 2 shqetësime, romët dhe tokat. Na jepni zgjidhje.


Banor i Cerkovinës: Kemi 2 shqetësime. Rruga e varrezave dhe ndricimi me llampa.

Banor i Pishporo: Problemi me tokat dhe certifikatat. Është bërë asfaltimi i rrugës por s'ka kullim, u mbytëm. Të ardhurat e bujqësisë dhe të mbjellat duhet të zgjidhet kullimi dhe vaditja.

Ermal Dredha-Kryetar i Bashkisë Vlorë: Problemet që u shprehën këtu i mbajtëm shënim dhe do shikojmë ti trajtojmë. Faleminderit që ishit pjesë e takimit!

a aiat/Për dijëni/Tjetër ditë

(TULLARD)



_____.2023

_____.2023

2023



Konceptori Albana Naçi

Koordinatorë për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

vlova.gov.al